



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 05.09.2016

Ref.: 790/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 Gusht, mori:

### V E N D I M

I. REFUZOHET kërkesa nr. 497/15, dt. 16.11.2015 e Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" për riakreditim të programit të studimit:

- Gjuhë dhe Letërsi Angleze, BA, 240 ECTS

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A r s y e t i m i

Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programit të studimit: Gjuhë dhe Letërsi Angleze, BA, 240 ECTS.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 25 Gusht 2016 ka trajtuar aplikacionin e Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 02/2013, datë: 16.01.2013, neni 11, pika 3.2, i cili kërkon që institucioni i arsimit të lartë të ketë të paktën tre PhD (Dr.sc.) në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program të studimit. Pas shqyrtimit të dosjes së stafit akademik, në pajtim me nenin 13, pika 1.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.02/2013, datë: 16.01.2013, KSHC ka konstatuar që ky aplikacion nuk i përmbush kushtet formale për aprovim dhe rrjedhimisht ka refuzuar aprovimin formal të aplikacionit të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" për programin e mësipërm të studimit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë